

VENDIM
Nr.1170, datë 13.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.835, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË
KAPITALIT TË SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, QË U OFROHET INVESTITORËVE STRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 3, 7, 8 e 9 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e instruksioneve për realizimin e tenderit për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që i bashkëlidhet vendimit nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në nënpikën 3.2.1 të pikës 3.2 “Garancia e ofertës”, fjalët “... në vlerën 10 % të ofertës financiare...” zëvendësohen me “... në vlerën 5 milionë euro...”.
- b) Në nënpikën 4.1.2 të pikës 4.1 “Vulosja dhe shënimi i ofertës”, fjalët “... MOS TË HAPET PËRPARA DATËS 1 SHTATOR 2008...” zëvendësohen me “...MOS TË HAPET PËRPARA DATËS 15 SHTATOR 2008...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha